Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP) 2000 – 2017

Ankesa = Vendimi

Mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore



Sistemi efektiv i drejtësisë zgjedhore

Administrimi i drejtësisë zgjedhore = Garantues i plotë i ligjit

Prishtinë, 2019

Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP) 2000 – 2017

Prishtinë, 2019

Botues:
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Për më shumë informata mund ta kontaktoni Sekretariatin e PZAP-it.

Adresa: Rr. "Migjeni" nr. 21, kati i parë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Telefoni: +383 (0) 38 211 242
E-mail: info@pzap-ks.org
Ueb faqe: www.pzap-ks.org

Ky dokument në formë raporti është hartuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Dokumenti përmban të dhënat për bazën ligjore mbi themelimin dhe avancimin e tij. Gjithashtu janë paraqitur të dhëna lidhur me procedimin, shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me ankesat dhe apelet për të gjitha zgjedhjet e organizuara në Kosovë nga viti 2000 deri në vitin 2017.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), ka siguruar të dhëna për ankesat dhe apelet në proceset zgjedhore për periudhën kohore 2000 – 2007. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa falënderon Misionin e OSBE-së, në Kosovë për ndihmën e dhënë në sigurimin e këtyre të dhënave, këshillave të vazhdueshme dhe mbështetjen financiare për shtypjen e këtij botimi.

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave 5
Hyrje 7
Historiku 9
Zgjedhjet në Kosovë 2000-2017 15
Procedura e administrimit dhe vendosjes lidhur me ankesat dhe apelet 17
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2000 19
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të vitit 2001 19
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2002 20
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të vitit 2004 20
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të vitit 2007 21
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2009 21
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të vitit 2010 22
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, të vitit 2012 23
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, të vitit 2012 23
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2013 24
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës të vitit 2014 25
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit të vitit 2016 25
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës të vitit 2017 26
Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2017 27
Numri i përgjithshëm i ankesave dhe apeleve gjatë viteve 2000 - 2017 27
Ankesat dhe apelet e paraqitura në ish KZAP dhe PZAP, nga viti 2009 deri në vitin 2017 nga subjekte të ndryshme 29
Ankesat dhe apelet e paraqitura në ish KZAP dhe PZAP, nga viti 2009 deri në vitin 2017 nga subjekte të ndryshme nëpër secilën komunë 34

Shkeljet e pretenduara sipas ankesave nga viti 2000 - 2017 37
Gjobat e shqiptuara ndaj subjekteve politike gjatë proceseve zgjedhore 2009 - 2017 40
Vendimmarrja për ankesa dhe apele 44
Numri i personave të cilëve iu është ndaluar pjesëmarrja si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor 47
Procedimi i rasteve me elemente të veprës penale në Prokurorinë e Shtetit 49
Vendimet e apeluara të PZAP-it në Gjykatën Supreme 51
Rastet e vendimeve të ish KZAP-it dhe PZAP-it të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese 53
Përfundimi 58

Lista e shkurtesave

FRK	Formulari i rezultateve të kandidatëve
FPR	Formulari i përputhjes së të dhënave dhe të rezultateve
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Këshilli i Vendvotimit
LZL	Ligji për Zgjedhjet Lokale
LZP	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PK	Policia e Kosovës
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
SP	Subjektet Politike
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
SPZAP	Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZRPPC	Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim

Hyrje

Historia e zgjedhjeve në Kosovën e pasluftës dhe zgjidhja e kontesteve zgjedhore, fillon në vitin 2000. Kosova ka shënuar progres të madh në organizimin e zgjedhjeve dhe në zgjidhjen e kontesteve zgjedhore. Për herë të parë zgjedhjet në Kosovën e pasluftës për Kuvende Komunale - Zgjedhjet Lokale, janë mbajtur më datë 28 tetor 2000, ndërsa Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës janë mbajtur më datë 17 nëntor 2001.

Për të vendosur për një ankesë ose apel, PZAP-i zhvillon hetime dhe vlerëson çdo dëshmi që ka në dispozicion. Për çdo ankesë ose apel vendoset në panel prej se paku tre anëtarëve (gjyqtarë). Vendimet e këtij institucioni janë të detyrueshme për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe subjektet pjesëmarrëse në zgjedhje. PZAP-i mund të rishikoj cilindo nga vendimet e marra për shkaqet e parapara me ligj. Vendimet e PZAP-it, mund të apelohen vetëm në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila është instanca e fundit e zgjidhjes së kontesteve zgjedhore. Këto vendime kanë fuqinë e titullit përmbarues.

Gjatë periudhës kohore 2000 - 2017, PZAP-i, ka arritur që të menaxhoj, procedoj dhe të vendos për gjitha ankesat dhe apelet brenda afateve ligjore, duke arritur të përmbushë detyrimet ligjore. Në këtë periudhë kohore zgjedhjet janë përcjell me një numër të madh të ankesave dhe apeleve, për shkak të parregullsive që i kanë përcjell proceset zgjedhore ndër vite.

Shkeljet dhe parregullsitë e evidentuara nga palët e interesit, kanë arritur të mënjanohen falë punës efektive dhe profesionale të PZAP-it përgjatë periudhës kohore të cekur më lartë.

Integriteti zgjedhor si parakusht i funksionimit të shtetit ligjor është diktuar nga garantimi i votës së lirë, drejtësisë efikase zgjedhore dhe këtë më së miri e ka garantuar PZAP-i.

Bazuar në funksionet dhe përgjegjësit e PZAP-it, e nëse i krahasojmë me funksionet dhe përgjegjësit e institucioneve tjera që marrin vendime lidhur me kontestet zgjedhore të natyrave të njëjta në rajon dhe më gjerë, mund të

konstatohet se PZAP-i, është një institucion unik në Ballkanin Perëndimorë dhe në Evropë.

Publikimi i këtij dokumenti në formë të raportit më të gjerë, është vazhdimësi e përkushtimit dhe përformancës të PZAP-it, për avancimin e drejtësisë zgjedhore, procedurës së ankimimit në procese zgjedhore dhe ngritjes së transparencës. Të dhënat e paraqitura në këtë publikim, përveç akterëve që merren me zgjedhjet dhe me zgjidhjen e kontesteve zgjedhore, do të mund t'iu shërbejnë edhe studiuesve të ndryshëm për hulumtime studimore të kësaj fushe.

Në këtë publikim, do të paraqitën informacione për: kompetencat, përbërjen e PZAP-it, administrimin e ankesave dhe apeleve, mënyrën e vendosjes së ankesave dhe apeleve, natyrën e shkeljeve, sanksionet për shkeljet e bëra dhe të dhëna tjera statistikore, për të gjitha proceset zgjedhore nga viti 2000 deri në vitin 2017, duke përfshirë shpjegimet e nevojshme për lexuesit.

Historiku

Integriteti i një procesi zgjedhor është treguesi më i mirë i demokracisë së një vendi dhe garantimit të votës së lirë. PZAP-i, me ekspertizën e krijuar ndër vite ka dëshmuar se është garantues i këtij integriteti.

PZAP-i, si organ i pavarur, i paanshëm, efikas dhe transparent ka një histori të tij të krijimit. PZAP-i, gjatë viteve 2000 - 2017 karakterizohet nga ndryshime substanciale në kompetenca dhe përbërjen e institucionit, duke siguruar ngritjen e kapaciteteve të këtij institucioni dhe integritetin e proceseve zgjedhore në Kosovë.

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 Qershor 1999, duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1, të ndryshuar, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 Korrik 1999, mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2000/21 të datës 18 prill 2000 ka themeluar KQZ-në[1].

Në bazë të nenit 4 paragrafi 4 nënparagrafi 3 pika (i) e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2000/21 të datës 18 prill 2000 për Themelimin e KQZ-së, një nder funksionet dhe përgjegjësitë e KQZ-së, të përcaktuara me këtë Rregullore, ka qenë edhe krijimi i një organi të ankesave të zgjedhjeve i cili siguron që veprimet/sanksionet do të merren dhe do të adresohen kundër çdo shkeljeje të rregullave zgjedhore dhe të cilësdo rregullore ose rregulle e cila i drejton zgjedhjet. Krijimi dhe ekzistimi i këtij organi është paraparë edhe me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2000/65 të datës 19 Dhjetor 2000 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2000/21 të datës 18 Prill 2000 për Themelimin e KQZ-së, neni 4 paragrafi 4 nënparagrafi 3 pika (j)[2].

[1] *Burimi: Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2000/21 për Themelimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,*
[2] *Burimi: Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2000/65 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2000/21 për Themelimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*

Me nenin 7 paragrafi 7.2 pika (e) të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/9 të datës 27 Prill 2004 mbi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)[3] nder përgjegjësit dhe funksionet e KQZ-së, shprehimisht parashihet edhe krijimi i komisionit për parashtresa dhe ankesa.

Ashtu që nga viti 2000 deri në 2002, Komisioni për Parashtresa dhe Ankesa ka vepruar si nën-komision, në kuadër të KQZ-së, ndërsa nga viti 2004 deri në vitin 2007, KZAP-i është caktuar dhe themeluar si organ i pavarur, me mandat të përkohshëm e me kompetenca të kufizuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të OKB-së, në Kosovë, për të vendosur lidhur me ankesat dhe parashtresat e lejuara përkitazi me procesin zgjedhor ashtu siç ishte përcaktuar me rregulloret, udhëzimet administrative dhe me rregullat zgjedhore në fuqi të asaj kohe.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa KZAP-i, si organ i pavarur dhe me kompetenca me të plota është caktuar me Kapitullin 8, të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/12 të datës 05 Maj 2004, Mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës[4]. Në bazë të kësaj Rregullore, KZAP-i, e ka caktuar Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm - PSSP-ja, së paku dy (2) muaj, para mbajtjes së zgjedhjeve. Me mandatin që i është dhënë me këtë Rregullore KZAP-i, ka qenë organ i pavarur me kompetenca për të vendosur lidhur me ankesat dhe parashtresat e lejuara përkitazi me procesin zgjedhor ashtu siç është përcaktuar me rregulloret, udhëzimet administrative dhe me rregullat zgjedhore në fuqi.

Përbërja e KZAP-i, ka qenë nga një (1) shef i komisionit dhe tre (3) apo katër (4) anëtarëve të komisionit të emëruar sipas vendimit të PSSP-së, në konsultim me kryetarin e KQZ-së.

Me këtë rregullore është përcaktuar edhe Procedura e KZAP-it, për vendosjen e ankesave, vendimmarrja, kush ka të drejtë të ankohet, mjetet dhe sanksionet për shkeljet e bëra, procedura e akreditimit të vëzhguesve të zgjedhjeve dhe ankesat/apelet e zgjedhjeve se në cilat raste mund të ushtrohet ankesë/apel ndaj vendimeve të KQZ-së, në KZAP.

[3] *Burimi: Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2004/9 Mbi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve*
[4] *Burimi: Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/12 Mbi Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës*

KZAP-i, si organ i pavarur është caktuar edhe me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2007/27 të datës 29 Gusht 2007, Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë[5]. Në Kapitullin 8, të kësaj Rregullore caktimi i KZAP-it, ka qenë i obliguar të bëhet jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë, para datës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve, në bazë të emërimeve nga Kryetari i Gjykatës Supreme, PSSP-ja, e cakton një panel gjyqtarësh nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe nga gjykatat e qarkut, të cilët do të shërbejnë si anëtarë të KZAP-it.

Në bazë të kompetencave të caktuara me këtë Rregullore, KZAP-i, është organ i pavarur me kompetenca për të vendosur lidhur me ankesat dhe parashtresat e lejuara përkitazi me procesin zgjedhor ashtu siç është përcaktuar në rregulloret, udhëzimet administrative dhe në rregullat zgjedhore në fuqi. Ushtrimi i funksioneve dhe përgjegjësive nga KZAP-i, bëhet pa i paragjykuar autorizimet e PSSP-së, për sigurimin e zbatimit të plotë të RKSKB, 1244 të vitit 1999 dhe Kornizën Kushtetuese, për të marrë masat e duhura kur është e nevojshme.

KZAP-i përbëhej nga pesë (5) anëtarë të Komisionit, duke përfshirë një (1) shef të Komisionit dhe katër (4) anëtarë të Komisionit. Së paku dy (2) nga anëtarët e Komisionit janë gjyqtarë ndërkombëtarë. KZAP-i mund të mbajë takime në panele ku marrin pjesë së paku tre (3) anëtarë, ku merr pjesë së paku një (1) gjyqtar ndërkombëtar. Gjyqtari ndërkombëtar është zyrtar kryesues i Komisionit në të gjitha panelet.

Ndryshimet me të rëndësishme ndodhën me rastin e aprovimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Zgjedhjet Lokale, me të cilin ligj është themeluar KZAP-i, si organ i pavarur, i përhershëm, kompetent për të vendosur lidhur me ankesat dhe apelet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Ndërsa më vonë në vitin 2010, me ndryshimet dhe plotësimet e LZP-së, ndryshohet përbërja, kompetencat dhe emërtimi nga **"KZAP" -** Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe zëvendësohet me **"PZAP"** - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP).

[5] *Burimi: Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2007/27 Mbi Zgjedhjet Komunale në Kosovë*

Periudha kohore nga viti 2008 - 2017

Me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP (Ligji nr. 03/L- 073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligji nr. 03 / L-072) me të cilin ligj u themelua edhe KZAP-i, Në bazë të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, KZAP-i, është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore. KZAP-i, përbëhej nga pesë (5) anëtar, përfshirë edhe kryesuesin të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, me mandat katër (4) vjeçar dhe mund të mblidhet në panele prej së paku tre (3) anëtarë. Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, në përputhje me ligjin e lartcekur ka emëruar anëtarët e KZAP-it, nga radha e gjykatësve të Gjykatës Supreme dhe gjykatave të qarkut. Kemi ndryshim të emrit nga KZAP-i, në PZAP (Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa), nga numri prej 5 anëtarëve, tani ka ndryshuar në 10 anëtar, që emërohen nga gjyqësori dhe atë: nga Gjykata Supreme emërohet kryesuesi i PZAP-it, ndërsa anëtarët tjerë emërohen nga radha e gjyqtarëve të gjykatave të qarkut, është bërë edhe ndryshim sa i përket kompetencës së panelit në vendimmarrje ashtu që vendimet e PZAP-it, nga viti 2010, kanë karakter detyrues-ekzekutiv ndaj vendimeve të KQZ-së, pasi që para vitit 2010 vendimet e ish KZAP-it, kanë pasur karakter udhëzues ndaj vendimeve të KQZ-së. Ndryshim tjetër ka qenë nga viti 2010, sa i përket vendosjes për një gjobë, ndaj subjekteve politike, ashtu që para vitit 2010, ish KZAP-i, ka pasur të drejtë të vendosë një gjobë, ndaj një subjektit politik në lartësi deri në 200.000 euro, ndërsa pas viti 2010, PZAP-i, ka të drejtë të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik deri në 50.000 euro.

PZAP-i, ndihmohet në ushtrimin e përgjegjësive të tij nga Sekretariati i cili është përgjegjës për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionin e PZAP-it, pranimin e ankesave, apeleve, arkivimin, përkthimin, hetimin e rasteve, mirëmbajtjen e adresës zyrtare, mundëson qasjen e palëve të interesuar në çdo kohë rreth vendimeve të PZAP-it, në të gjitha gjuhët zyrtare, përgatitjen e materialit të nevojshëm për panel dhe punë tjera administrative të përcaktuara me ligj.

ORGANOGRAM i PZAP-it



PZAP-i, gjatë viteve të fundit ka shënuar ngritje në aspektin e infrastrukturës sekondare ligjore siç janë: rregullat e brendshme të cilat përcaktojnë dhe determinojnë aspektet e funksionimit të brendshëm, por disa nga to i referohen apo përcaktojnë rregulla në raport me administrimin e ankesave dhe apeleve, vendimmarrja, gjobat ndaj subjekteve të cilët e shkelin Kodin e Mirësjelljes etj. Shikuar nga aspekti i infrastrukturës, PZAP-i, është në hap me kohën, është i kompletuar në këtë drejtim dhe i koordinuar në përputhje me standardet më të larta.

Në kuadër të PZAP-it, funksionojnë dy komisione të përhershme që përbëhen nga anëtarët e PZAP-it:

1. Komisioni për Çështje Ligjore i përberë prej 5 (pese) anëtarëve të panelit,
2. Komisioni për Buxhet dhe Personel i përberë prej 5 (pese) anëtarëve të panelit.

Ndryshimet e cekura më lartë të PZAP-it, flasin më së miri për transformimin dhe fuqizimin e këtij institucioni ndër vite, ku përveç kësaj PZAP-i, gjatë viteve ka shënuar transformim edhe në drejtim të ngritjes së ekspertizës profesionale në raport me vendimmarrjen.

PZAP-i, udhëhiqet nga disa parime bazë: i ligjshmërisë, i pavarësisë, i paanshmërisë, i efikasitetit, i transparencës, llogaridhënies, integritetit, kredibilitetit dhe parimi i bashkëpunimit.

Këto parime bazë të PZAP-it, të njëjtit i japin përgjegjësi më të madhe dhe avancim të vazhdueshëm si nga aspekti i vendimmarrjes, transparencës në publikim, zhvillimit të metodave bashkëkohore, përmes së cilave synim të vetëm ka ngritjen e kredibilitetit të publiku në përgjithësi, por edhe te akterët tjerë zgjedhor në veçanti.

Nga vitet 2010 e tutje, PZAP-i, në vazhdimësi përmes mësimeve të nxëna ka arritur të vlerësojë, analizojë dhe ndryshoj aspektet e ngritjes profesionale, duke shërbyer vitet paraprake si mësime të nxjerra, për përmirësimin e lëshimeve eventuale dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale drejt përgatitjes për sfidat e së ardhmes.

Në ditët e sotme mund të themi se me mënyrën e funksionimit, operimin dhe kapacitetet profesionale të tij, PZAP-i, mund të shërbej si model i një institucioni të pavarur, profesional, të pa anshëm dhe efektiv drejt mbrojtës së votës së lirë, garantimit të integritetit zgjedhor, i cili mund të merret si model i tillë edhe në rajon dhe më gjerë.

Zgjedhjet në Kosovë 2000-2017

Në tabelën Nr. 1 janë paraqitur informatat e përgjithshme për të gjitha ciklet zgjedhore të mbajtura nga viti 2000 deri në vitin 2017, duke i përfshirë zgjedhjet për kuvende komunale, raundin e dytë të zgjedhjeve për kuvende komunale, zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të komunave, zgjedhjet në rastet kur procesi i votimit është kthyer në rivotim dhe zgjedhjet për Kuvend të Kosovës, siç janë paraqitur në tabelën e më poshtme.

Tabela 1. *Proceset zgjedhore në Kosovë 2000 - 2017*

Nr.	Proceset zgjedhore	Data e mbajtjes së zgjedhjeve
1	Zgjedhjet për Kuvende Komunale	28.10.2000
2	Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës	17.11.2001
3	Zgjedhjet për Kuvende Komunale	26.10.2002
4	Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës	23.10.2004
5	Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës	17.11.2007
6	Zgjedhjet për Kuvende Komunale dhe për Kryetar të Komunave	17.11.2007
7	Raundi i dytë i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave	07.12.2007
8	Zgjedhjet për Kuvende Komunale dhe për Kryetar të Komunave	15.11.2009
9	Raundi i dytë i zgjedhjeve për Kryetar të Komunave	13.12.2009
10	Rivotimi për Kryetar të Komunave në Prizren dhe Lipjan	31.01.2010
11	Rivotimi për Kryetar të Komunës në Gjilan	14.03.2010
12	Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Istog	11.04.2010
13	Raundi i dytë i Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Istog	09.05.2010
14	Zgjedhjet për Kuvend Komunal dhe për Kryetar të Komunës në Partesh	20.06.2010
15	Raundi i dytë i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës në Partesh	18.07.2010
16	Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komune në Rahovec	21.11.2010
17	Raundi i dytë i zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Rahovec	19.12.2010
18	Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës	12.12.2010

Nr.	Proceset zgjedhore	Data e mbajtjes së zgjedhjeve
19	Rivotimi i Zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës, në Komunat Gllogoc, Skenderaj, Lipjan, Malishevë dhe Deçan	09.01.2011
20	Rivotimi i Zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës në Komunën e Mitrovicës	23.01.2011
21	Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Ferizaj	29.04.2012
22	Raundi i dytë i zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Ferizaj	27.05.2012
23	Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Kaçanik	17.06.2012
24	Zgjedhjet për Kuvend Komunal dhe për Kryetar të Komunave	03.11.2013
25	Rivotimi i Zgjedhjeve për Kuvende Komunale dhe për Kryetar Komune në Komunat Mitrovica Veriore, Zveçan dhe në Partesh	17.11.2013
26	Raundi i dytë i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave	01.12.2013
27	Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Mitrovicën e Veriut	23.02.2014
28	Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës	08.06.2014
29	Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Graçanicë	18.01.2015
30	Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Gllogoc	04.12.2016
31	Raundi i dytë i Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Gllogoc	18.12.2016
32	Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës	11.06.2017
33	Zgjedhjet për Kuvende Komunale	22.10.2017
34	Raundi i dytë i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave	19.11.2017
35	Rivotimi i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës në Partesh	19.11.2017
36	Rivotimi i Raundit të Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës në Istog	17.12.2017

Procedura e administrimit dhe vendosjes lidhur me ankesat dhe apelet

PZAP-i, bazuar në LZP-në, rregullat dhe procedurat e tij, pranon ankesat, të njëjtat i protokollon, ku secila ankesë identifikohet me numër të saj të veçantë, për të u proceduar më tutje. Paneli e shqyrton ankesën dhe sipas nevojës të njëjtën e kthen në plotësim të parashtruesi i ankesës, në rast se e njëjta nuk i përmbushë kërkesat në bazë të nenit 118 të LZP-së, rregullave dhe procedurave të PZAP-it, për parashtrimin e një ankese.

Paneli, para se të vendos për një ankesë, bënë hetimin dhe administrimin e nevojshëm, varësisht nga natyra dhe lloji i ankesës. Në këtë mënyrë Paneli, gjatë proceseve zgjedhore dhe sipas kompetencës së tij, mund të kërkojë informacione nga: Policia e Kosovës, Komisionet Komunale Zgjedhore, ZRPPC, KQZ, por duke mos u kufizuar vetëm në këto institucione, meqenëse çdo institucion është i obliguar të i ofrojë ndihmë PZAP-it, sipas LZP-së.

PZAP-i, ka të drejtën që të hedhë poshtë një ankesë si të parregullt, të pasafatshme, të palejuar, ta refuzon si të pabazuar, të pranon si të bazuar, të shpallet inkompetent për çështje lëndore dhe me qëllim të përshpejtimit dhe ekonomizimit të procedurës, ka të drejtën që të bashkoj ankesat kur të njëjtat për nga përmbajtja janë identike.

Për ta sqaruar në mënyrë më të detajuar rrjedhën e administrimit dhe mënyrën e vendosjes lidhur me një ankesë apo apel, mund të i referoheni diagramit të më poshtëm.

Diagrami se si procedohen dhe administrohen ankesat dhe apele në PZAP



Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2000

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), në atë kohë si institucion që ka vepruar si nën-komision Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në kuadër të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet për kuvende komunale të mbajtura në vitin 2000, ka pranuar 319 ankesa: për fushatën zgjedhore, për numërim dhe për fazat tjera të procesit zgjedhor. Po ashtu gjatë këtij procesi zgjedhor KZAP-i, ka pranuar dhe i ka gjykuar 4,852 ankesa, të cilat kanë pasur të bëjnë me votuesit jashtë Kosovës.

Tabela 2. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2000*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Për parregullsitë për ditën e zgjedhjeve	125
		Për numërim	2
		Për fazat tjera të procedurës zgjedhore	192
2	Apelet nga votuesit jashtë Kosovës	Regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës	4,852
Gjithsejtë:			**5,171**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të vitit 2001

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të mbajtura në vitin 2001, ka pranuar 276 ankesa: për fushatën zgjedhore, për numërim dhe për fazat tjera të procesit zgjedhor. Po ashtu gjatë këtij procesi zgjedhor KZAP-i, ka pranuar dhe i ka gjykuar 5,089 ankesa të cilat kanë pasur të bëjnë me votuesit jashtë Kosovës.

Tabela 3. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të vitit 2001*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Për parregullsitë për ditën e zgjedhjeve	41
		Për fazat tjera të procedurës zgjedhore	235
2	Apelet nga votuesit jashtë Kosovës	Regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës	5,089
Gjithsejtë:			**5,365**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2002

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), për zgjedhjet për kuvendet komunale të mbajtura në vitin 2002, ka pranuar 294 ankesa: për fushatën zgjedhore, për numërim dhe për fazat tjera të procesit zgjedhor. Po ashtu gjatë këtij procesi zgjedhor KZAP-i, ka pranuar dhe i ka gjykuar 1,425 ankesa, të cilat kanë pasur të bëjnë me votuesit jashtë Kosovës.

Tabela 4. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2002*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Për parregullsitë për ditën e zgjedhjeve	53
		Për fazat tjera të procedurës zgjedhore	241
2	Apelet nga votuesit jashtë Kosovës	Regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës	1,425
Gjithsejtë:			**1,719**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të vitit 2004

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), në vitin 2004, u formua si organ i veçantë i emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të

Përgjithshëm (PSSP), të OKB-së (jo më nën - komision i KQZ-së), por vazhdoi të mbesë organ i përkohshëm, për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës, ka pranuar Gjithsejtë 254 ankesa: për fushatën zgjedhore, për numërim dhe për fazat tjera të procesit zgjedhor.

Tabela 5. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të vitit 2004*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Për parregullsitë për ditën e zgjedhjeve	73
		Apele për regjistrimin e votuesve	46
		Për fazat tjera të procedurës zgjedhore	135
Gjithsejtë:			**254**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të vitit 2007

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të mbajtura në vitin 2007, ka pranuar Gjithsejtë 390 ankesa, për të gjitha fazat e procesit zgjedhor.

Tabela 6. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të vitit 2007*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat	Për të gjitha fazat të procedurës zgjedhore	390
Gjithsejtë:			**390**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) i formuar me ligj për zgjedhjet e përgjithshme në vitin 2008, si institucion i pavarur dhe i

përhershëm, për zgjedhjet për kuvendet komunale të mbajtura në vitin 2009, ka pranuar 544 ankesa: për fushatën zgjedhore, për numërim dhe për fazat tjera të procesit zgjedhor.

Tabela 7. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2009*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Shkelja e kodit të mirësjelljes	122
		Për parregullsitë gjatë procesit të votimit	292
		Mos përputhje të votave gjatë numërimit	60
		Për shpërndarjen e ulëseve për Kuvende Komunale	10
		Për mos deklarimin e raporti financiar gjatë fushatës zgjedhore	40
2	Apelet për procedurën zgjedhore	Apele të parashtruara ndaj vendimeve të KQZ-së	20
Gjithsejtë:			**544**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të vitit 2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), është ndryshuar në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ky institucion për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës, të mbajtura në vitin 2010, ka pranuar Gjithsejtë 454 ankesa dhe apele: për të gjitha fazat e procesit zgjedhor.

Tabela 8. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës të vitit 2010*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Shkelja e kodit të mirësjelljes	180
		Për parregullsitë gjatë procesit të votimit	255
2	Apelet për procedurën zgjedhore	Apele të parashtruara ndaj rezultateve të zgjedhjeve	19
Gjithsejtë:			**454**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, të vitit 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, të mbajtura në vitin 2012, ka pranuar 91 ankesa: për fushatën zgjedhore, për numërim dhe për fazat tjera të procesit zgjedhor.

Tabela 9. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, të vitit 2012*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Për fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë	13
		Për fushatën zgjedhore	22
		Për thyerjen e heshtjes zgjedhore	15
		Për parregullsitë gjatë procesit të votimit	41
Gjithsejtë:			**91**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, të vitit 2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, të mbajtura në vitin 2012, ka pranuar 29 ankesa: për fushatën zgjedhore, për numërim dhe për fazat tjera të procesit zgjedhor.

Tabela 10. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, të vitit 2012*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Për fushatën zgjedhore	11
		Për thyerjen e heshtjes zgjedhore	4
		Për parregullsitë gjatë procesit të votimit	14
Gjithsejtë:			**29**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), për zgjedhjet për kuvende komunale të mbajtura në vitin 2013, ka pranuar dhe vendos 1,064 ankesa dhe 45 apele: për fushatën zgjedhore, për numërim dhe për fazat tjera të procesit zgjedhor, si dhe ka vendosur edhe për 16,410 apele ndaj vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me të cilat vendime u janë refuzuar aplikacionet që të regjistrohen si votues jashtë Kosovës.

Tabela 11. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvendet Komunale të vitit 2013*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Për fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë	33
		Për fushatën zgjedhore	258
		Për thyerjen e heshtjes zgjedhore	32
		Për parregullsitë gjatë procesit të votimit	254
		Për rezultatin preliminar	225
		Për rezultatin përfundimtar	262
2	Apele për procedurën zgjedhore	Apele ndaj vendimeve të KQZ-së	45
3	Apelet nga votuesit jashtë Kosovës	Regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës	16,410
Gjithsejtë:			**17,519**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës të vitit 2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), për zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës, të mbajtura në vitin 2014, ka pranuar dhe ka vendosur 326 ankesa dhe 15 apele: për fushatën zgjedhore, për numërim dhe për fazat tjera të procesit zgjedhor, si dhe ka vendosur edhe për 9.172 apele, ndaj vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me të cilat vendime u janë refuzuar aplikacionet që të regjistrohen si votues jashtë Kosovës.

Tabela 12. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës të vitit 2014*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Për fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë	3
		Për fushatën zgjedhore	153
		Për administrimin në QNR	6
		Për thyerjen e heshtjes zgjedhore	36
		Për parregullsitë gjatë procesit të votimit	46
		Për rezultatin preliminar	21
		Për rezultatin përfundimtar	61
2	Apele për procedurën zgjedhore	Apele ndaj vendimeve të KQZ-së	15
3	Apelet nga votuesit jashtë Kosovës	Regjistrimi i votuesve jashtë Kosovës	9,172
Gjithsejtë:			**9,513**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit të vitit 2016

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), për zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit, të mbajtura në vitin

2016, ka pranuar dhe vendosur për 17 ankesa: për fushatën zgjedhore, për numërim si dhe për fazat tjera të procesit zgjedhor.

Tabela 13. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit të vitit 2016*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Për fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë	3
		Për fushatën zgjedhore	2
		Për thyerjen e heshtjes zgjedhore	3
		Për parregullsitë gjatë procesit të votimit	9
Gjithsejtë:			**17**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës të vitit 2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), për zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës, të mbajtura në vitin 2017, ka pranuar dhe vendosur për 400 ankesa dhe 21 apele: për fushatën zgjedhore, për numërim si dhe për fazat tjera të procesit zgjedhor.

Tabela 14. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës të vitit 2017*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Për fushatën zgjedhore	177
		Për thyerjen e heshtjes zgjedhore	88
		Për parregullsitë gjatë procesit të votimit	67
		Për rezultatin preliminar	2
		Për rezultatin përfundimtar	66
2	Apele për procedurën zgjedhore	Apele ndaj vendimeve të KQZ-së	21
Gjithsejtë:			**421**

Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), për zgjedhjet për kuvende komunale të mbajtura në vitin 2017, ka pranuar dhe vendosur 1,142 ankesa: për fushatën zgjedhore, për numërim si dhe për fazat tjera të procesit zgjedhor.

Tabela 15. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në zgjedhjet për Kuvende Komunale të vitit 2017*

Nr.	Ankesë / Apel	Shkeljet e pretenduara sipas ankesave/apeleve	Numri i ankesave
1	Ankesat për procedurën zgjedhore	Për fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë	35
		Për fushatën zgjedhore	226
		Për thyerjen e heshtjes zgjedhore	57
		Për parregullsitë gjatë procesit të votimit	195
		Për rezultatin preliminar	89
		Për rezultatin përfundimtar	540
Gjithsejtë:			**1,142**

Numri i përgjithshëm i ankesave dhe apeleve gjatë viteve 2000 - 2017

Në këtë pjesë pasqyrohet numri i përgjithshëm i ankesave dhe apeleve, të paraqitura gjatë proceseve zgjedhore gjatë viteve 2000 - 2017. Përgjatë kësaj periudhe, numri i përgjithshëm i ankesave dhe apeleve, arrin shifrën 42,629. Kjo pasqyronë më së miri për ngarkesën në punë të PZAP-it dhe ish KZAP-it, përgjatë kësaj periudhe, njëkohësisht kjo shifër pasqyron rezultatet e këtij institucioni, rëndësia e të cilit tanimë është evidente, tek të gjithë akterët zgjedhorë.

Me qëllim të ofrimit të një pasqyre sa më të qartë për lexuesin, ankesat dhe apelet e përgjithshme pasqyrohen në dy periudha kohore, ku ndarja do të ketë kriter të vetëm, menaxhimin e Panelit nga ndërkombëtarët dhe vendorët.

Në tabelën Nr.16, është paraqitur ndarja e ankesave dhe apeleve për dy periudha, 2000 – 2007, kur KZAP-i, është menaxhuar nga ndërkombëtarët dhe pas vitit 2007, kur menaxhimin e KZAP-it, tani PZAP-it, e marrin në menaxhim vendorët.

Tabela 16. *Numri i përgjithshëm i ankesave dhe apeleve gjatë viteve 2000 - 2017*

Nr.	**Menaxhimi i KZAP-it nga ndërkombëtarët**	**Numri i ankesave/apeleve**
1	Zgjedhjet për Kuvend Komunal - 2000	5,171
2	Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës - 2001	5,365
3	Zgjedhjet për Kuvend Komunal - 2002	1,719
4	Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës - 2004	254
5	Zgjedhjet për Kuvend të Kosovë - 2007	390
6	Zgjedhjet për Kuvend Komunal - 2007	
Gjithsejtë:		**12,899**
Nr.	**Menaxhimi i KZAP-it dhe PZAP-it nga vendorët**	**Numri i ankesave/apeleve**
7	Zgjedhjet për Kuvend Komunal - 2009	544
8	Zgjedhjet për Kuvend të Kosovë - 2010	454
9	Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizaj dhe Kaçanik - 2012	120
10	Zgjedhjet për Kuvend Komunal - 2013	17,519
11	Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës - 2014	9,513
12	Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Gllogocit – 2016	17
13	Zgjedhjet për Kuvend Komunal - 2017	421
14	Zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës - 2017	1,142
Gjithsejtë:		**29,730**
Numri i përgjithshëm:		**42,629**



Ankesat dhe apelet e paraqitura në ish KZAP dhe PZAP, nga viti 2009 deri në vitin 2017 nga subjekte të ndryshme

Në tabelën Nr.17, janë paraqitur të gjitha ankesat dhe apelet e ushtruara në ish KZAP dhe PZAP, nga viti 2009 deri në vitin 2017[6], nga subjektet politike, iniciativat qytetare, kandidatët e pavarur dhe personat tjerë fizik dhe juridik që kanë pasur interes ligjor.

[6] Me rastin e punimit të këtij dokumenti PZAP-i, nuk ka pasë ndarje të të dhënave lidhur me ankesat dhe apelet e paraqitura nga subjekte të ndryshme, që kanë garuar në zgjedhje apo që kanë pasur interes ligjor për vitet 2000-2007, pasi që ish KZAP-i, në atë kohë ka qenë nën administrimin ndërkombëtar.

Tabela 17. *Ankesat dhe apelet e paraqitura në ish KZAP dhe PZAP nga viti 2009 deri në vitin 2017 nga subjekte të ndryshme*

Nr.	Subjekti që ka parashtruar ankesë në ish KZAP dhe PZAP nga viti 2009-2017	Zgjedhjet për Kuvende Komunale - 2009		Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës - 2010		Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune Ferizaj dhe Kaçanik - 2012		Zgjedhjet për Kuvende Komunale - 2013		Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës - 2014		Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvend të Kosovës - 2017		Zgjedhjet për Kuvende Komunale - 2017		Gjithsejtë ankesa dhe apele
		Ankesa	Apele	Ankesa	Apele	Ankesa	Apele	Ankesa	Apele	Ankesa	Apele	Ankesa	Apele	Ankesa	Apele	Total
1	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	25	-	18	-	-	-	40	1	2	-	-	-	59	47	192
2	Alternativa Demokratike e Kosovës (ADK)	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
3	Aleanca Kosova e Re (AKR)	50	1	52	1	-	-	18	1	15	2	-	-	21	21	182
4	Alternativa	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	13	10	23
5	Aktivna Građanska Inicijativa (AGI)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	1
6	Balkan Investigative Reporting Network (BIRN)	-	-	39	-	12	-	27	-	2	-	37	-	128	-	245
7	Bošnjačka Jedinstvena Lista (BJL)	-	-	-	-	-	-	-	-	2	1	-	-	-	-	3
8	Bošnjačka Stranka Demokratske Akcije Kosova (BSDAK)	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
9	Bošnjačka Unija Kosova (BUK)	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
10	Centar Demokratske Unije (CDU)	-	-	-	-	-	-	-	-	1	1	-	-	-	-	2
11	Crnogorska Demokratska Partija (CDS)	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
12	Demokracia në Veprim	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
13	Demokracia Plus	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	46	-	-	-	46
14	Fryma e Re (FER)	-	-	42	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	43
15	G.I. Krilo Naroda	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
16	Iniciativa Demokratike për Integrim (IDI)	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
17	Iniciativa për Progres (INPO)	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	1
18	Jedinstvena Srpska Lista (JSL)	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
19	Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP)	1	-	1	2	-	-	4	-	7	-	4	1	-	2	22
20	Bashkimi Demokratik (BD)	-	-	-	-	-	-	13	-	-	-	-	-	-	-	13

Nr.	Subjekti që ka parashtruar ankesë në ish KZAP dhe PZAP nga viti 2009-2017	Zgjedhjet për Kuvende Komunale - 2009		Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës - 2010		Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune Ferizaj dhe Kaçanik - 2012		Zgjedhjet për Kuvende Komunale - 2013		Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës - 2014		Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kuvend të Kosovës - 2017		Zgjedhjet për Kuvende Komunale - 2017		Gjithsejtët ankesa dhe apele
		Ankesa	Apele	Ankesa	Apele	Ankesa	Apele	Ankesa	Apele	Ankesa	Apele	Ankesa	Apele	Ankesa	Apele	Total
21	Građanska Inicijativa Zajedno za Opstanak (GIZZO)	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
22	Grupi Ndërkombëtar i Krizave Prishtinë (GNKP)	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
23	I.Q. Koha	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
24	Hrvatska Stranka Kosova (HSK)	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	1
25	Iniciativa Qytetare e Drenasit	-	-	-	-	-	-	1	1	-	-	-	-	-	-	2
26	Iniciativa Qytetare e Malishevës	-	-	-	-	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-	2
27	International Crisis Group	5	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	5
28	Iniciativa Qytetare "Zavičaj"	7	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	7
29	Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ)	13	-	-	-	-	-	10	1	-	-	3	-			27
30	Vakat	4	-	-	-	-	-	3	-	-	1	1	-	1	-	10
31	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
32	Komuna e Graçanicës	-	-	-	-	-	-	6	-	-	-	-	-	-	-	6
33	Këshilli i Vendvotimit (KVV)	1	-	-	-	1	-	2	-	1	-	2	-	1	-	8
34	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)	-	-	1	-	-	-	10	-	-	-	71	-	26	-	108
35	Kosovo Turk Adalet Partisi (KTAP)	-	-	-	-	-	-	7	1	6	2	1	1	3	1	22
36	Kosova Turk Birligi (KTB)	-	-	-	-	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-	2
37	Kosovaki Nevi Romani Partia (KNRP)	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	2	-	-	-	3
38	Koalicija Za Gora	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	1
39	Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD)	26	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	27
40	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	120	4	29	1	23	-	84	3	14	-	58	1	59	92	488
41	Lëvizja për Integrim dhe Zhvillim	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	1
42	Lëvizja Vetëvendosje!	-	-	173	1	61	-	155	2	124	-	71	-	106	54	747

